



KËSHILLI DREJTUES I RTSH
NR. 791 PROT

Tiranë më 06.03.2020

VENDIM
NR. 9, date 06.03.2020

Në zbatim të nenit 102 pikat 2/ç dhe 12 të ligjit nr 97/2013, datë 04.03.2013 "Për median audiovizive në RSH", nenit 17 të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr 98, datë 22.12.2016 "Për miratimin e Statutit të RTSH", pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH me shkresën nr 778 prot, date 06.03.2020, mbi miratimin e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH për vitin 2020, Këshilli Drejtues i RTSH në mbledhjen e tij datë 10.03.2020 me votimin pro të 8 anëtarëve të pranishëm K.Traja, Xh.Aliu, Xh.Mato H.Haliti, P. Përvathi, S. Kumbaro, A.Peqini dhe V.Grosha;

VENDOSI:

I. Të miratojë strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH për vitin 2020 si më poshtë vijon:

➤ NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE

- Të shtohen 2 (dy) vende pune në emërtesën „Specialist Ekonomist“ në Drejtorinë Ekonomike në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH.
- Shkurtohen 4 (katër) vende pune me emërtesë „Punonjëse Pastrimi“ në Drejtorinë e Administratës në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH dhe kalojnë në Struktura e Departamentit të Prodhimit.
- Shkurtohet Sektori i Web në Drejtorinë e Promocionit dhe WEB në Drejtorinë e Përgjithshme me 7 (shtatë) vende pune e cila kalon në Njesisë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve.
Drejtoria e Marketingut në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH të rikoncepohet në emërtesën „Drejtoria e Shitjes dhe Menaxhimit të Trafikut“
- Drejtoria e Promocionit dhe WEB në Drejtorinë e Përgjithshme ndryshon në emërtesën Drejtoria e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut dhe rikoncepohet me 12 (dymbëdhjetë vende) pune /ne struktura organizative te vitit 2019 Drejtoria e Promocionit dhe ËEB ka qene me 18 (tetembedhjete vende pune).
- Qëllimi i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut është:
Krijta e qëndrueshme e audiencës së RTSH-së ONAIR DHE ONLINE, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të strategjive dhe taktikave të marketingut tradicional dhe atij dixhital për fuqizimin e brandit dhe rritjen e imazhit dhe reputacionit të RTSH-së, të kanaleve të transmetimit dhe të gjitha programeve që prodhohen dhe transmetohen nga kanalet e RTSH-së.



Drejtoria e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut, është përgjegjëse për hartimin e planeve dhe krijimin e skenareve (story board) për të gjitha spotet promocionale që do të transmetohen on air dhe online, për promovimin e programeve radio-televizivë, për promovimin e kanaleve të transmetimit të radios, televizionit dhe online, si edhe për promovimin e brandit zyrtar të RTSH-së.

Drejtoria e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut është përgjegjëse gjithashtu për krijimin e materialeve të tjera promocionale, si edhe promovimin intensiv të brandit korporativ RTSH-së, të kanaleve të transmetimit dhe të gjitha programeve radio-televizive.

Drejtoria e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut do të bashkëpunojë me Njësinë e Programeve dhe Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, për krijimin, dhe transmetimin e të gjitha spoteve radio-televizive dhe materialeve të tjera promocionale.

Drejtoria e Grafikës dhe sektorët e tjerë në Departamentin e Prodhimit, si Sektori i Kameramanëve, Sektori i Montazhit, etj., janë përgjegjëse për zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit të hartuara nga Drejtoria e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut, lidhur me realizimin grafik dhe prodhimin e të gjitha spoteve radio-televizive, posterave promocional, realizimin e imazheve, videove dhe punimeve të tjera që i shërbejnë promocionit të RTSH-së, kanaleve të transmetimit radio-televizive dhe programeve.

Drejtoria e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut përbëhet prej sektorëve dhe pozicioneve të mëposhtëm:

a. Drejtori i Drejtorisë

Drejtori është përgjegjës për:

- Hartimin e strategjive të promocionit për fuqizimin e brandit korporativ të RTSH-së dhe kanaleve të transmetimit radio-televizive dhe online.
- Hartimin e strategjive të promocionit për fuqizimin e brandit të programeve radio-televizive.
- Hartimin e strategjive për vlerësimin e audiencës së programeve të RTSH-së, si edhe për studimin e tregut dhe konkurrentëve të RTSH-së.
- Përcaktimin e objektivave të punës të Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Hartimin e planit 1 vjeçar të veprimtarisë së DPKT dhe planeve të punës sipas muajve për sektorët nën varësinë e tij.
- Udhëheqjen dhe organizimin e veprimtarisë së DPKT me qëllim të implementimit të strategjive dhe realizimin e objektivave të vendosura.
- Vlerësimin e performancës së punës për përgjegjësit e sektorëve nën varësinë e tij dhe të gjithë punonjësve të DPKT.
- Koordinimin e punës së DPKT me njësitë, dhe strukturat e tjera përbërëse të RTSH-së, por edhe subjektet jashtë RTSH-së, për realizimin e objektivave, strategjive dhe planeve të veprimit të DPKT.
- Raportimin te Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së për realizimin e objektivave të vendosura dhe informacione të tjera të kërkuara prej tij.





b. Sektori i Promocionit

Ky sektor është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e strategjive të promocionit on air, online dhe tradicional për promovimin intensiv të brandit korporativ të RTSH, të kanaleve të radios dhe televizionit dhe të gjitha programeve radio-televizive.

Sektori i Promocionit përgjigjet për kordinimin e punës me Njësinë e Programeve, Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, autorët e programeve, etj., për konceptimin e spoteve, mesazheve promocional, posterave dhe materialeve të tjera promocional, për fuqizimin e brandit korporativ dhe të programeve.

Ky sektor është përgjegjës për kordinimin e punës me Drejtorinë së Grafikës dhe sektorët e tjerë të Departamentit të Prodhimit, për realizimin dhe prodhimin e spoteve, posterave dhe materialeve të tjera promocional, si edhe për planifikimin dhe ndjekjen e cilësisë së transmetimit të spoteve në të gjitha kanalet e RTSH-së onair dhe online, si edhe realizimin e promocionit të brandit korporativ dhe programeve nëpërmjet broshurave, billbordeve, citylight -ve, dhe mënyrave të tjera tradicionale të promocionit.

Sektori i promocionit përgjigjet për ndjekjen e marrëdhënieve me mediat dhe publikun, menaxhimin e problemeve që mund të shfaqen lidhur me imazhin dhe reputacionin e RTSH-së dhe përmirësimin dhe rritjen e vazhdueshme të tyre.

Ky sektor është përgjegjës edhe për mirëmbajtjen teknike dhe menaxhimin e ëbsitit dhe faqeve zyrtare të RTSH-së në mediat e ndryshme sociale si Facebook, Instagram, Youtube, etj.

Në përbërje të këtij sektori janë:

1 Përgjegjësi i Sektorit

Është përgjegjës për planifikimin, koordinimin, drejtimin dhe kontrollin e të gjithë veprimtarisë së sektorit.

Ai është përgjegjës për realizimin e objektivave të veprimtarisë së sektorit dhe raporton te Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

2. Menaxheri i Promocionit të Brandit Korporativ

Është përgjegjës për konceptimin e të gjitha materialeve dhe mesazheve promocional si logo, slogane, spote, postera, broshura, kartvizita, billborde, etj., për promovimin dhe fuqizimin e brandit korporativ të RTSH-së.


Ai përgjigjet për realizimin e këtyre materialeve në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Grafikës dhe sektorëve të tjerë të Drejtorisë së Prodhimit, si edhe ndjekjen e transmetimit të tyre me shumë cilësi në kanalet online dhe onair.


Ai merr detyra nga eprorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Promocionit dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

3. Menaxheri i Promocionit të Lajmeve dhe Sportit

Është përgjegjës për konceptimin e të gjitha materialeve dhe mesazheve promocional si logo, spote, postera, broshura, kartvizita, billborde, etj., për ndërtimin e brandit dhe promovimin e

Address: "Ismail Qemal" Street, No.11, Tirana, Albania





RTSH 24 , RTSH Sport dhe emisioneve dhe programeve të lajmeve dhe sportit, që transmetohen në të gjitha kanalet e RTSH -së.

Ai përgjigjet për realizimin e këtyre materialeve në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Grafikës dhe sektorëve të tjerë të Drejtorisë së Prodhimit, si edhe ndjekjen e transmetimit të tyre me shumë cilësi në kanalet online dhe onair.

Ai merr detyra nga eprorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Promocionit dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

4. Menaxheri i Promocionit të Emisioneve Tematike

Është përgjegjës për konceptimin e të gjitha materialeve dhe mesazheve promociional si logo, spote, postera, broshura, kartvizita, billborde, etj, për ndërtimin e brandit dhe promovimin e emisioneve tematike që transmetohen nga RTSH.

Ai përgjigjet për realizimin e këtyre materialeve në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Grafikës dhe sektorëve të tjerë të Drejtorisë së Prodhimit, si edhe ndjekjen e transmetimit të tyre me shumë cilësi në kanalet online dhe onair.

Ai merr detyra nga eprorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Promocionit dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

5. Menaxheri i Promocionit të Programeve

Është përgjegjës për konceptimin e të gjitha materialeve dhe mesazheve promociional si logo, spote, postera, broshura, kartvizita, billborde, etj., për ndërtimin e brandit dhe promovimin e programeve të ndryshme si spektakle, dokumentarë, filma, emisione për fëmijë, etj., që transmetohen nga RTSH.

Ai përgjigjet për realizimin e këtyre materialeve promociional në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Grafikës dhe sektorëve të tjerë të Drejtorisë së Prodhimit, si edhe ndjekjen e transmetimit të tyre me shumë cilësi në kanalet online dhe onair.

Ai merr detyra nga eprorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Promocionit dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.


6. Menaxheri i Marrëdhënieve me Publikun

Është përgjegjës për krijimin dhe implementimin e strategjive të ndërtimit të marrëdhënieve dhe komunikimin me publikun, për rritjen e ndërgjegjësimit për vlerat e RTSH-së, rritjen e reputacionit të RTSH-së dhe menaxhimin e problematikave negative që mund të dëmtojnë imazhin e RTSH-së.

Ai merr detyra nga eprorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Promocionit dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

7. Zëri Zyrtar i RTSH

Është një zë unik që do të shërbeje për realizimin e të gjitha spoteve të RTSH, me qëllim për t'i bërë ato të dallueshme me spotet e konkurentëve dhe kompanive të tjera, cka do të ndikoj në fuqizimin e brandit të RTSH-së.





Ai merr detyra nga eprorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Promocionit dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

8. Webmaster

Është përgjegjës për mirëmbajtjen teknike, përmirësimin e vazhdueshëm dhe funksionimin normal të ëbsitit zyrtar të RTSH dhe ëbsiteve të tjera që i përkasin veprimtarisë së strukturave përbërëse të RTSH. Gjithashtu ai është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të faqeve zyrtare të RTSH-së dhe strukturave përgjegjëse në mediat sociale si Facebook, Instagram, Youtube, LinkedIn, etj.

Ai merr detyra nga eprorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Promocionit dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

c. Sektori i Kërkimit të Tregut

Ky sektor është përgjegjës për vlerësimin e kënaqësisë së audiencës lidhur me vlerat e ofruara nga RTSH, vlerësimin e shikueshmërisë së kanaleve dhe programeve të transmetuara nga RTSH-së, si edhe për studimin e programeve që transmetohen nga kompanitë konkurente, pikave të forta dhe të dobëta të konkurrentëve dhe vlerësimin e nevojave të publikut apo grupeve të ndryshme të interesit për realizimin e programeve që mund të jenë me shumë interes për ato.

Në përbërje të këtij sektori janë:

1 Përgjegjësi i Sektorit

Është përgjegjës për planifikimin, koordinimin, drejtimin dhe kontrollin e të gjithë veprimtarisë së sektorit.

Ai është përgjegjës për realizimin e objektivave të veprimtarisë së sektorit dhe raporton te Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

2. Specialist i Vlerësimit të Audiencës


Ai është përgjegjës për ndërtimin e një sistemi profesional të bazuar në mbledhjen e informacionit online dhe nëpërmjet sondazheve dhe anketimeve të drejtëpërdrejta për vlerësimin e kënaqësisë së audiencës lidhur me vlerat e ofruara nga RTSH, vlerësimin e shikueshmërisë së kanaleve dhe programeve të transmetuara nga RTSH, si edhe realizimin në praktikë të këtyre vlerësimeve.

Ai bën edhe vlerësimin e nevojave të publikut apo grupeve të ndryshme të interesit për realizimin e programeve që mund të jenë me shumë interes për ato dhe informon në mënyrë periodike njësitë përgjegjëse për krijimin e programeve dhe emisionet tematike dhe lajmet.

Ai merr detyra nga eprorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimit të Tregut dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

3. Specialist i Studimit të Konkurrentëve

Ai është përgjegjës për ndjekjen e vazhdueshme dhe studimin e të gjitha programeve dhe reklamave që transmetohen nga kompanitë konkurente brenda vendit, kryen analizën e pikave të forta dhe të dobëta të tyre nga pikëpamja e përmbajtjes, realizimit artistik, prezantimit, të ftuarve,



etj., kragasuar me programet dhe emisionet që transmetohen nga RTSH dhe informon në mënyrë periodike njësitë përgjegjëse për krijimin e programeve dhe emisionet tematike dhe lajmet. Gjithashtu ai ndjek në mënyrën e promovimit të kompanive konkurente dhe programeve që transmetohen prej tyre dhe informon Sektorin e Promocionit. Ai merr detyra nga eprrorët e tij dhe bashkëpunon me punonjës të tjerë brenda dhe jashtë sektorit për realizimin e këtyre detyrave dhe objektivave të vendosura. Ai raporton te Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimit të Tregut dhe Drejtori i Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

Sruktura organizative e Drejtorisë së Promocionit dhe Kërkimit të Tregut do të përbëhet nga punonjësit actual që ajo ka, si edhe disa plotësime me punonjës të rinj të cilët mund të rekrutohen nga brenda personelit të RTSH-së, ose nga jashtë saj.

Klasat e pagës për punonjësit actual mbeten ato ekzistuese, ndërsa pagat për pozicionet e reja janë përcaktuar duke marrë parasysh klasat e pagës së pozicioneve eksistuese.

N r	POZICIONI I PUNËS	Nr. i Punonjesve
1	Drejtor Drejtorie	1
2	Përgjegjës i Sektorit të Promocionit	1
3	Menaxher i Promocionit të Brandit Korporativ	1
4	Menaxher i Promocionit të Lajmeve dhe Sportit	1
5	Menaxher i Promocionit të Emisioneve Tematike	1
6	Menaxher i Promocionit të Programeve	1
7	Menaxher i Marrëdhënieve me Publikun	1
8	Zëri Zyrtar i RTSH-së	1
9	Web Master	1
10	Përgjegjës i Sektorit të Kërkimit të Tregut	1
11	Specialist i Vlerësimit të Audiencës	1
12	Specialist i Studimit të Konkurrentëve	1
	Gjithesëj	12


NDRYSHIME NË LIBRIN E PAGAVE

- Të shtohet në klasën e XI të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa "Përgjegjës i Sektorit të Promocionit" në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Të shtohet në klasën e IX të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa "Menaxher i Promocionit të Brandit Korporativ" në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.

Address: "Ismail Qemali" Street, No.11, Tirana, Albania

Phone: + 355 4 22 27 512
Fax: + 355 4 22 27 745
e-mail: info@rtsh.al

www.rtsh.al




- Të shtohet në klasën e IX të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa “Menaxher i Promocionit të Lajmeve dhe Sportit” në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Të shtohet në klasën e IX të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa “Menaxher i Promocionit të Emisioneve Tematike” në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Të shtohet në klasën e IX të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa “Menaxher i Promocionit të Programeve” në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Të shtohet në klasën e IX të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa “Menaxher i Marrdhenieve me Publikun” në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Të shtohet në klasën e XI të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa “Përgjegjës i Sektorit të Kërkimit të Tregut” në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Të shtohet në klasën e IX të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa “Specialist i Vleresimit të Audiencës” në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Të shtohet në klasën e IX të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa “Specialist i Studimit të Konkurrentëve” në Drejtorinë e Promocionit dhe Kërkimit të Tregut.
- Të hiqet në klasën e X të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa „Redaktor përgjegjës“.
- Të hiqet në klasën e VIII të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa “Specialist WEB”.
- Të hiqet nga klasa e XI e Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa Zeri zyrtar i RTSH dhe të kalojë në klasën e VIII të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme.
- Të hiqet nga klasa e VII të librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme emërtesa Arkiviste protokolliste e të kalojë në klasën e VIII të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme.

II. Numri i vendeve të punës në Strukturën Organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së për vitin 2020 është 110.

III. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 prill 2020.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Kristaq TRAJA



RADIO
TELEVISIONI
SHQIPTAR

STRUKTURA ORGANIZATIVE E DREJTORISE SE PËRGJITHSHME TE RTSH PER VITIN 2020

Nr.	EMERTESA	NR. I VENDEVE	TOTALI
			2
1	Drejtor i Përgjithshëm	1 (një)	
2	Zv/Drejtor i Përgjithshëm	1 (një)	3
KABINETI			
1	Shef Kabineti	1 (një)	
2	Këshilltar i Jashtëm	1 (një)	
3	Ass. Juridik i KD dhe BA (i jashtëm)	1 (një)	1
1	Drejtor i Transmetimeve Lokale	1 (një)	3
DREJTORIA E AUDITIT TE BRENDSHËM			
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	
2	Specialist auditit	2 (dy)	4
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË			
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	
2	Specialist	3 (tre)	7
DREJTORIA E SHITJES & MANAXHIMIT TE TRAFIKUT			
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	
2	Asistent Finance Marketingu	1 (një)	
3	Trafik Manager	1 (një)	
3	Manager Marketingu	4 (katër)	4
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE			
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	
2	Specialist	3 (tre)	2
AKADEMIA			
1	Drejtor i akademise	1 (një)	9
1	Specialist	1 (një)	
DREJTORIA EKONOMIKE			
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	
2	Përgjegjës i Sek. kontabilitetit	1 (një)	
3	Specialist	5 (pese)	
4	Specialist ekonomist rrisku	1 (një)	
5	Magaziner	1 (një)	5
DREJTORIA JURIDIKE			
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	
2	Jurist	4 (katër)	5
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT & PROKURIMEVE			
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	

2	Specialist	3 (tre)	
3	Specialist planifikimesh & ndjekje investimesh	1 (një)	
Sektori i Projekteve & Administrimit të të Drejtave			3
1	Përgjegjës Sektori	1 (një)	
2	Specialist (ekonomist)	1 (një)	
3	Specialist	1 (një)	
DREJTORIA E ADMINISTRATES			50
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	
2	Ass. e Drejtorit të Përgjithshëm	1 (një)	
3	Ass. e Zv/Drejtorit te Pergjithshem	1 (një)	
4	Arkiviste / Protokolliste	2 (dy)	
5	Pastruese	14 (katërbëdhjetë)	
6	Receptioniste	5 (pesë)	
7	Teknik /mekanik	1 (një)	
8	Teknik /elektriciçist	1 (një)	
9	Teknik/murator	1 (një)	
10	Teknik/kondicionerist	1 (një)	
11	Teknik /hidraulik	1 (një)	
12	MKZ	2 (dy)	
13	Marangoz	1 (një)	
14	N/Biblioteke	1 (një)	
15	Bahçevean	1 (një)	
16	Përgjegjës i Sek. Mirëmbajtjes Automjeteve	1 (një)	
17	Shofer	13 (trembëdhjetë)	
Sektori GIS (regjistrimin & administrimin e pronave)			
1	Përgjegjës Sektori	1 (një)	
2	Specialist	1 (një)	
DREJTORIA E PROMOCIONIT & KËRKIMIT TË TREGUT			12
1	Drejtor drejtorie	1 (një)	
Sektori I Promocionit			
2	Përgjegjës i Sektorit të Promocionit	1 (një)	
3	Menaxher i Promocionit të Brandit Korporativ	1 (një)	
4	Menaxher i Promocionit të Lajmeve dhe Sportit	1 (një)	
5	Menaxher i Promocionit të Emisioneve Tematike	1 (një)	
6	Menaxher i Promocionit të Programeve	2 (dy)	
7	Menaxher i Marrëdhënieve me Publikun	2 (dy)	
8	Zëri zyrtar i RTSH	1 (një)	
9	Web Master	1 (një)	
Sektori i Kërkimit të Tregut			
10	Përgjegjës i Sektorit të Kërkimit të Tregut	1 (një)	
11	Specialist i Vlerësimit të Audiencës	1 (një)	
12	Specialist i Studimit të Konkurrentëve	1 (një)	

SHËNIM:

•Kjo Struktura ka 110 vende pune

